REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 30/05/2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 37 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.37**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. paragafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE: 692-4, 694-2, 693-3 Z.K.PRELEZ I JERLIVE, PRONË PRIVATE ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 1178-0 Z.K.PRELEZ I JERLIVE, PRONË E KOMUNËS FERIZAJ.

### I

**Shpallen interes i përgjithshëm-publik pjesët e ngastrës kadastrale:**

- **692-4 Z.K.Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 31m², pronë e Mehmet dhe Indira Mustafa**
- **693-3 Z.K.Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 33m², pronë e Gazmen Mustafa dhe**
- **694-2 Z.K.Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 149m², pronë e Gazmen Mustafa.**

### II

Ngastrat kadastrale Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive të njejtat shërbejnë për rregullimin e parcelave si dhe me këtë këmbim krijohen kushte më të lehta për qasje të parcelave me të cilat kufizohen.

### III

Në këto prona të cilat këmbehen nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

### IV

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne Date / Dana: 30,02,2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 Nr.Prot. Br.Prot. 38 Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.38**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE: 963-1 Z.K.TALINOVC I MUHAXHERVE, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 7-0 Z.K.MUHOVC, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

### I

Shpallen interes i përgjithshëm-publik pjesët e ngastrës kadastrale:
963-1 Z.K.Talinoc i Muhaxherve, me sipërfaqe prej 2298m², pronë e Nafije dhe Bahri Xhemajli.

### II

Ngastrat kadastrale Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc të njejtat shërbejnë për rregullimin e parcelave si dhe me këtë këmbim krijohen kushte më të lehta për qasje të parcelave me të cilat kufizohen.

### III

Në këto prona të cilat këmbehen nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

### IV

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

**V**

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmëive.

**VI**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne Date / Dana: 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 39 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.39**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafu 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE; 3206-0 Z.K. FERIZAJ, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTËRS KADASTRALE 489-16 Z.K. FERIZAJ, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

### I

Shpallen interes i përgjithshëm-publik pjesët e ngastrës kadastrale: 3206-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 341 m², pronë e Kemajl (Zahir) Berisha, nenqirambajtje 99 vite.

### II

Ngastrat kadastrale Shpallet interes i përgjithshëm-publik me qëllim të zgjerimit të brezit të rrugës "Driton Islami", dhe krijimin e shiritit për dalje nga "Stacioni i autobusëve" deri te rruga "Cen Dugolli".

### III

Pjesa e parcelës kadastrale 3206-0 Z.K. Ferizaj këmbehet me pjesen e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, sepse Komuna e Ferizajt nuk ka të planifikuar buxhet për shpronësim për këtë projekt.

### IV

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara 489-16 Z.K. Ferizaj në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcelat kadastrale 3206-0 Z.K. Ferizaj, është e regjistruar në emër të Kemajl (Zahir) Berisha, nenqirambajtje 99 vite, në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

V

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

VI

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne Date / Dana: 30/05/2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 40 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.40**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/l-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Ligjit Nr.04/L-074 për Sistem të Adresave, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 mori këtë:

**VENDIM**
**PËR VAZHDIMIN E MANDATIT TË KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE, RRUGICAVE DHE SHESHEVE PËR KOMPLETIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE KOMUNALE.**

**I**

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr 01.Nr.110 I datës 21.05.2024 për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Sheshеve për kompletimin e sistemit të adresave komunale.

**II**

**Komisioni do të ketë këtë përbërje të anëtarëve:**

1. Koordinator- Faik Selmani;
2. Ekspert i Komunikacionit – Agon Kamenica;
3. Zyrtare për futjen e të dhënave në ARIS – Blerona Hamiti;
4. Zyrtar për mbledhjen e të dhënave në teren – Argjend Osmani;
5. Zyrtar për mbledhjen e të dhënave në teren – Astrit Musliu;
6. Zyrtar për mbledhjen e të dhënave në teren – Artin Jashari.

**III**

Mandati i këtij komisioni do të jetë për periudhën kohore 1 (një) vjeçare.

**IV**

Kompensimi për koordinatorin do të jetë 30% e pagës bazë së asambleistit ashtu si e parasheh ligji i pagave.
Kompensimi për anëtarët e tjerë të këtij komisioni do të jetë në shumën prej 500€ (pesëqind euro) në muaj.

**V**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

______________________

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 41 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.41**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NEVOJA TË BANORËVE TË ZASKOKUT

## I

Lokacioni për ndërtimin e objektit në fshatin Zaskok caktohet në parcelën kadastrale 955-0 Z.K. Zaskok me sipërfaqe prej 5 ari (500 m2), pronë e Komunës së Ferizajt.

## II

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të fshatit Zaskok.

## III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e fshatit Zaskok.

## IV

Obligohet Kryetari i Komunës që të lidh marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e fshatit Zaskok, ashtu siç e Parasheh Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

## V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kreytari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

_________________________

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne. Date / Dana. 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 42 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.42**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligji Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QMF-SË NË KOSHARE

**I**

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Koshare në parcelen kadastrale 845-0 Z.K. Koshare me sipërfaqe prej 33.50 ari (3350 m2), pronë e Komunës së Ferizajt, nga kjo sipërfaqe 5 ari janë të desinuar për bust (lapidar).

**II**

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare, sipas projektit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale.

**III**

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga Komuna e Ferizajt.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kreytari i Komunës, Drejtoria e Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese · Izlazne: Date / Dana: 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 43 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.43**
**Data: 30.05.2024**

Në mbështetje te nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, te nenit 6 pika 1.2, neni 21 pika 1.3 të Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 5 pika 1.3, neni 13, neni 24 pika 1 dhe 5, neni 25 pika 6 të Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE 710-0 Z.K. BIBAJ, ME SIPËRFAQE PREJ 6 M², KEDS-SH.A.**

**I**

Pjesa e ngastrës së lartëcekur i ipet në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuimin dhe Furnizimin me Energji Elektrike- SH.A.(KEDS), me qëllim të realizimit të projektit ndërtimi i TS 10/04,250 Kva Konstruksion shtylle metalike dhe L.P 10 (20) kv nëntokësore me gjatësi prej 0.04km dhe rekonstruimi i RR.T.U.

**II**

Afati për dhënie në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale të lartëcekur është 99 vite.

**III**

Pjesa e ngastrës kadastrale të lartëcekur ipet në shfrytëzim me kompensim, shuma e kompenzimit është 1 (një) euro në muaj për një m², në total për të gjithë sipërfaqën e lartëcekur, mënyra e pagesës së kësaj qiraje përcaktohet me marrveshje, e njejta mund të paguhet çdo muaj apo njëherë në vit.

**IV**

Kuvendi i Komunës me këtë vendim e autorizon Kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të lidhë kontratë me përfituesin.

**V**

Obligohet drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operatin kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore, ndarjes së parceles dhe nënshkrimit të kontratës

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne. Date / Dana: 30 / 05 / 2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 44 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.44**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 pika 12.1 dhe 12.2 shknja c, nenit 40 pika 40.2 shkronja a, nenit 58 shkronja h të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 7 pika 1.2 të UA (MAPL) Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, nenit25, paragrafi 2 pika 2.1 nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50 i datës 28.06.2013 si dhe nenit 19 pika 1 të UA (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR VËNIE NË KOSULTIM PUBLIK TË DRAFT-STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË NË KOMUNËN E FERIZAJT 2024-2029 DHE DRAFT PLANIN E VEPRIMIT PËR RININË 2024-2027

## I

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës Ferizaj me Nr. 109/24 i datës 17.05.2024 për vënie në kosultim publik të Draft-Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Draft Planin Veprimit për Rininë 2024-2027.

## II

Vëhet në konsultim publik Draft-Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Draft Planin Veprimit për Rininë 2024-2027.

## III

Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqitën ditën e debatit publik, i cili do të caktohet në afatet e parapara ligjore si dhe njoftimi për diskutim publik do të paraqitet në veb faqen e komunës.

## IV

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Kulturës Ferizaj si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

## V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE - FERIZAJ UROŠEVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse · Izlazne · Date / Dana: 30.05.2024
Nr.Orgv / Org.jed.: 01 | Nr.Prot. / Br.Prot.: 45 | Nr.Faqeve / Br.Strana: 2



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.45**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR KËMBIMIN E NGASTRAVE KADASTRALE; 1243-0, 1244-0 DHE 1245-3 Z.K SOJEVË, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 295-1 Z.K. FSHAT I VJETËR, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

### I

**Me këtë vendim pjesët e ngastrave kadastrale:**

1243-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 6424 m², pronë e Florent (Danush) Aliu nënqirambajtje 99 vite, 1244-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 4993 m², pronë e Florent (Danush) Aliu nënqirambajtje 99 vite dhe 1245-3 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 3561 m², pronë e Florent (Danush) Aliu nënqirambajtje 99 vite,

**Këmbehen me:**
Pjesën e ngastrës kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, me sipërfaqe prej 23396 m² (2h e 33 ari e 96m²) pronë, pronë e Komunës së Ferizajt.

### II

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen me qëllim të zgjerimit të varrezave në Fshatin Sojevë si dhe një pjesë e parcelës do të shërbejë për rrugë.

### III

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të komunës me Nr. 01. Nr. 90, datë 29.09.2023, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e komunës është vlerësuar 9.80 € për m², prona private- parcela kadastrale 1243-0 Z.K. Sojevë është vlerësuar 13.00 € për m², 1244-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 4993 m², është vlerësuar 16.00 € për m², 1245-3 Z.K. Sojevë me sipërfaqe prej 3561 m² ², është vlerësuar 18.50 € për m2, andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi.

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**IV**

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Kadastrit Ferizaj si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
FERIZAJ
UROŠEVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse · Izlazne · Date / Dana 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 46 | Nr.Faqeve Br.Strana 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.46**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën: 30.05.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR KËMBIMIN E PJESËVE TË NGASTRAVE KADASTRALE; 467-2 Z.K. PRELEZ I JERLIVE, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTËRS KADASTRALE 469-0 Z.K. PRELEZ I JERLIVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.**

**I**

Me këtë vendim pjesa e ngastrës kadastrale: 467-2 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 316 m², pronë e Xhemajl Hajdini dhe Hysni Hajdini, këmbehet me: Pjesën e ngastrës kadastrale 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 316 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

**II**

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive në pronësi të Komunës së Ferizajt dhe parcela kadastrale 467-2 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 316 m², pronë e Xhemajl Hajdini dhe Hysni Hajdini. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

**III**

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen me qëllim të rregullimit të parcelave dhe krijimin e kushteve më të lehta për çasje të pronave me të cilat kufizohen parcelat në fjalë.

**IV**

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të komunës me Nr. 01. Nr. 117, datë 30.11.2023, në bazë të të cilit vendim është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive pronë e komunës, është vlerësuar 30.00€ për m², prona private është vlerësuar 30.00€ për m², andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi.

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**V**

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Kadastrit Ferizaj si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne Date / Dana 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 47 | Nr.Faqeve Br.Strana 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.47**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë te nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR. 01. NR.2863 TË DATËS 30.11.2005

**I**

Me këtë vendim bëhet Plotësim Ndryshimi i Vendimit me Nr. 01. Nr.2863 të datës 30.11.2005 përmes së cilit është bërë ndarja-destinimi i ngastra kadastrake 180-10 Z.K. Talinovc i Jerlive për lapidarin e dëshmorit "Driton Islami".

**II**

Pika I e Vendimit me Nr.01.Nr.2863 të datës 30.11.2005 ndryshohet vetëm për sa i përket sipërfaqes, ashtu që pjesa e destinuar për parkun dhe lapidarin është e dëshmorit të kombit "Driton Islami", 10 ari (1000 $m^2$).

**III**

Pikat tjera të vendimit Nr.01.Nr.2863 të datës 30.11.2005 të cilat nuk preken nga ky propozim mbesin në fuqi.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis, Dejtoria e Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne Date / Dana: 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 Nr.Prot. Br.Prot. 48 Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.48**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë te nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR.01. NR. 111 TË DATËS 31.08.2022

**I**

Me këtë vendim plotësohet-ndryshohet Vendimi me Nr. 01. Nr. 111 të datës 31.08.2022 përmes së cilit është Shpallur Interesi i Përgjithshëm pjesa e ngastrës Kadastrale 498-7 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe 500 $m^2$ (5 ari) me objektin ekzistues.

**II**

Pika II e Vendimit me Nr. 01. Nr. 111 të datës 31.08.2022 ndryshohet vetëm për sa i përket numrit të parcelës nga 498-7 në 3487-3 Z.K. Ferizaj si dhe sipërfaqes së parcelës nga 500 $m^2$ (5 ari) në 342 $m^2$ (3 ari e 42 $m^2$), pra parcela kadastrale për shpallje interes i përgjithshëm është 3487-3 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe 342 $m^2$, s'bashku me objekt.

**III**

Parcela kadastrale e cila do të këmbehet s'bashku me objekt ndërtimor do të regjistrohet në emër të Komunës së Ferizajt.

**IV**

Pikat tjera të vendimit Nr. 01. Nr. 111 të datës 31.08.2022 të cilat nuk preken nga ky propozim mbesin në fuqi.

**V**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Dejtoria e Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë.

**VI**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese - Izlazne Date / Dana: 30 / 05 / 2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 49 | Nr.Faqeve Br.Strana 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.49
Data: 30.05.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 mori këtë:

**VENDIM**

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT ME NR.01.NR.28 TË DATËS 29.03.2024**

**I**

**ANULOHET**: Vendimi me Nr.01.Nr.28 i datës 29.03.2024 përmes të cilit është ndryshuar Rregullorja për biznese me theks të veçantë pjesa e punës së barnatoreve

**II**

Shkaku i anulimit nga Kuvendi është rishqyrtimi nga MAPL-ja dhe pritja deri sa të gjindet një zgjidhje më e përshtatshme për këtë kategori.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne. Date / Dana: 30 / 05 / 2024
Nr.Orgv / Org.jed. 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 50 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.50**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 dhe 14 të Udhëzimit administrativë Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për siguri në bashkësi, si dhe në bazë të nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

## VENDIM

## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.40 TË DATËS 28.02.2022

### I

Me këtë Vendim Plotësohet-Ndryshohet Vendimi i datës 28.02.2022 me Nr. protokoli 01.Nr.40 vetëm sa i përket anëtarëve nga LVV, ku në vend të:

**Brahim Osmani, emërohet Arbnor Murseli.**

### II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr.01.Nr.40 i datës 28.02.2022 mbesin në fuqi.

### III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

### IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
REJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne Date / Dana 30.05.2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 51 | Nr.Faqeve Br.Strana 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.51**
**Data: 30.05.2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 dhe 14 të Udhëzimit administrativë Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për siguri në bashkësi, si dhe në bazë të nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**

**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR.01.NR.34 TË DATËS 30.04.2024**

**I**

Me këtë Vendim Plotësohet-Ndryshohet Vendimi i datës 30.04.2024 me Nr.protokoli 01.Nr.34 dhe ndryshohet:

Në preambulë të vendimit në vend të shumës: 1,269,634.92€ bëhet 1,269,461.16€.

- Tek neni II në vend të 1,269,634.92 € bëhet 1,269,461.16€.
- Tek neni III pika 1 Shpenzime Komunale 149,634.92€ bëhet 149,461,16€
- Tek neni III Gjithsej, mjete për bartje në vend të 1,269,634.92€ bëhet 1,269,461.16€
- Po ashtu te neni III TEK Administrata e përgjitshme në vend të shumës prej 149,634.92€ bëhet-ndryshohet në 149,461.16€, si dhe në nenin III gjithsej në vend të 149,634.92 bëhet 149,461.16€.

**II**

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr.01.Nr.34 i datës 30.04.2024 mbesin në fuqi.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**